



Procedurat Standarde të Veprimit për Migrimin e Brendshëm

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtime.....	4
Përkufizime.....	5
1. Përmbledhje ekzekutive.....	5
2. Modelet e Migrimit të Brendshëm në Shqipëri.....	7
2.1 Dinamikat Aktuale të Migrimit të brendshëm.....	8
3. Qëllimi.....	10
4.Parimet dhe Standardet.....	11
4.1 Parimet.....	11
4.2 Standardet që Udhëheqin Punën e Punonjësve të Bashkive	12
5. Fushëveprimi dhe Grupi i Synuar	12
6. Kuadri përkatës ligjor, i politikave dhe institucional	13
6.1 Kuadri i Politikave Ndërkombëtare.....	13
6.2 Kuadri Kombëtar Ligjor, Institucional dhe i Politikave,.....	14
6.3 Kuadri i Politikave Vendore.....	20
6.4 Kuadri Ligjor	21
6.5 Detyrat dhe Përgjegjësitë e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, në lidhje me migrimin, sipas ligjit për Vetëqeverisjen Vendore.....	24
7. Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Punonjësit e Bashkive që Ndihmojnë Migrantët e Brendshëm.....	26
7.1 Vendosja e Kushteve për Menaxhimin Efektiv të Migracionit të Brendshëm	27
7.2 Forcimi i Komunikimit dhe Shtrirjes.....	27
7.2.1 Zhvillimi i Kanaleve Gjithëpërfshirëse Informative	27
7.2.2 Zhvillimi dhe Shpërndarja e Materialeve Informuese.....	28
7.2.3 Promovimi i Njësive të Migracionit dhe Diasporës	28
7.2 Përmirësimi i Efikasitetit së Njësive të Migracionit dhe Diasporës	29
7.3.1 Vlerësimi i Nevojave të Kapaciteteve.....	29
7.3.2 Bashkëpunimi Ndërbashkiak dhe Ndërinstitucional	29
7.3.3 Menaxhimi i të Dhënave dhe Raportimi.....	29
7.3.4 Monitorimi dhe vlerësimi	30
8. Asistimi i migrantëve të brendshëm nëpërmjet Informacioneve, Shërbimeve dhe Referimeve	31

8.1	Hapi i Parë Për Asistencën Për Migrantët e Brendshëm.....	31
8.1.1	Konsultimi dhe Vlerësimi Fillestar	31
8.2	Informacione që Ofrohen nga Punonjësi i Bashkisë:	31
8.2.1	Shërbime në lidhje me strehimin dhe mbështetjen për qiranë:.....	32
	Informacione të tjera relevante mbi strehimin.....	33
8.2.2	Asistencë në lidhje me Punësimin	33
8.2.3	Aksesi në Shërbime Shëndetësore	33
8.2.4	Shërbime Të Kujdesit Shoqëror dhe Asistencë Sociale	34
8.2.5	Udhëzime për Grupet Vulnerabël	34
8.2.6	Informoni migrantët e brendshëm në lidhje me portalin e-Albania dhe udhëzoni ata përmes procesit të regjistrimit, duke mundësuar aksesin në shërbimet publike thelbësore.	34
8.2.7	Përdorimi i platformës e-albania:.....	36
8.2.8	Rëndësia e regjistrimit të vendit të saktë të banimit dhe ndryshimit të tij në platformë kur individ kalon në një adresë të re:	37
8.2.9	Mundësi për zhvillim profesional:.....	38
8.2.10	Drejtoni migrantët tek Agjencitë e Punësimit Private që veprojnë në territor për ndihmë më të specializuar në ndjekjen e mundësive të punës	39
8.2.11	Regjistrimi i fëmijëve në shkolla (shërbim e-albania)	39
	Shtojca 1 Formular për Këshillim	42

Shkurtime

VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PZM	Profili i Zgjeruar i Migracionit
PGM	Pakti Global i Migracionit
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
NJVV	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
SHKZHEI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
PSV	Procedura Standarde Veprimi

Përkufizime

Për qëllimet e këtij dokumenti, termit e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

Migrimi i brendshëm: I referohet lëvizjes së njerëzve brenda kufijve të një vendi, zakonisht midis rajoneve, qyteteve ose zonave rurale të ndryshme.

Grupet vulnerabël: Grupe vulnerabël janë popullsi ose komunitete që janë në një rrezik më të lartë të përjetimit të dëmtimit, cenueshmërisë ose marginalizimit për shkak të faktorëve specifikë socio-ekonomikë, demografikë, shëndetësorë ose kulturorë.

Fenomeni demografik dhe socio-ekonomik: I referohet një ngjarjeje, tendence ose procesi që lind dhe ndikon në përbërjen, shpërndarjen dhe sjelljen e popullsisë (aspektet demografike) dhe sistemet e tyre ekonomike dhe sociale (aspektet socio-ekonomike).

Lëvizja nga fshati në qytet: I referohet migrimit të njerëzve nga zonat rurale (fshatrat ose rrethinat) në zonat urbane (qyteza ose qytete). Ky proces shpesh nxitet nga kërkimi i mundësive më të mira, duke përfshirë punësimin, arsimin, kujdesin shëndetësor dhe përmirësimin e standardeve të jetesës.

1. Përmbledhje ekzekutive

Migrimi i brendshëm në Shqipëri paraqet një fenomen demografik dhe socio-ekonomik të rëndësishëm me pasoja të konsiderueshme për zhvillimin e vendit. Ndër vite, modelet e migrimit janë formësuar nga faktorë ekonomikë dhe socialë, duke çuar në një lëvizje të dukshme nga zonat rurale në qendrat urbane, veçanërisht Tiranë, por edhe qytete të tjera të mëdha. Kjo lëvizje ka krijuar mundësi për rritje dhe modernizim, por gjithashtu ka paraqitur sfida të rëndësishme, përfshirë pabarazitë rajonale, mbipopullimin urban dhe shpopullimin e zonave rurale.

Këto Procedura Standarde të Veprimit (PSV) kanë si qëllim ofrimin e një kuadri të strukturuar për adresimin e nevojave të ndërlikuara të migrantëve të brendshëm dhe menaxhimin e pasojave të migrimit si për komunitetet urbane ashtu edhe për ato rurale. Ato theksojnë rëndësinë e mbështetjes së integritetit të migrantëve në mjediset e tyre të reja, veçanërisht në fushat e arsimit, punësimit, shëndetësisë dhe strehimit. Duke krijuar udhëzime dhe procedura të qarta dhe praktike, PSV-të synojnë të sigurojë që migrimi i brendshëm të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm, duke minimizuar sfidat socio-ekonomike që mund të sjellë.

Megjithëse migrantët e brendshëm nuk janë një grup i veçantë i njohur si grup vulnerabël sipas ligjit shqiptar, është e rëndësishme të merret parasysh se migrantët e brendshëm mund të jenë pjesë e grupeve vulnerabël që janë në fakt të njohura nga ligji shqiptar, siç janë nënat e vetme, fëmijët, minoritetet, etj.

Pavarësisht tendencës së vazhdueshme të shqiptarëve për të kërkuar punësim jashtë vendit, këto PSV kanë si qëllim të theksojnë dhe promovojnë mundësitë që ofrohen brenda vendit, duke inkurajuar zhvillimin kombëtar dhe fuqizimin e individëve për të ndërtuar një jetë më të mirë brenda vendit. Emigrimi i popullsisë, dhe veçanërisht i punonjësve me aftësi të larta, paraqet sfida të rëndësishme që çojnë në mungesa të fuqisë punëtore në vend, veçanërisht në sektorë të rëndësishëm me kërkesë të lartë të brendshme. Për shembull, humbja e profesionistëve të shëndetësisë, si mjekët dhe infermierët, dhe specialistëve të IT-së mund të ketë ndikime negative të menjëhershme në produktivitet, inovacion dhe rritje ekonomike.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor me popullsi të plakur dhe nivele të ulëta lindjesh, këto largime thellojnë sfidat demografike, përkeqësojnë mungesat e fuqisë punëtore dhe zgjerojnë pabarazitë midis rajoneve që janë duke përparuar dhe atyre që janë në situatë më të vështirë dhe të pazhvilluara¹. Këto tendenca gjithashtu ngrenë shqetësime për qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit të pensioneve. Nga një perspektivë fiskale, largimi e punonjësve të kualifikuar dhe të paguar më shumë ul bazën tatimore, duke krijuar më shumë presion mbi financat publike të vendit.

Për të adresuar këtë sfidë, autoritetet bashkiake duhet të promovojnë në mënyrë aktive mundësitë që fuqizojnë individët për të ndërtuar të ardhmen e tyre brenda Shqipërisë. Këto përfshijnë programe edukimi dhe trajnime profesionale, iniciativa për promovimin e punësimit, burime për garancinë rinore, mbështetje për ndërmarrjet dhe asistencë financiare për bizneset e vogla.² Duke komunikuar në mënyrë efektive këto alternativa, mund të inkurajohen emigrantët potencialë të mendojnë për përfitimet e qëndrimit në Shqipëri, duke kontribuar në komunitetet e tyre dhe në avancimin socio-ekonomik të vendit. Kjo qasje jo vetëm që kundërshton tendencat e emigracionit, por gjithashtu promovon zhvillimin e qëndrueshëm kombëtar.

E bazuar në Strategjinë Kombëtare të Migracionit dhe e harmonizuar me praktikën më të mira ndërkombëtare, këto PSV shërbejnë si një mjet praktik për autoritetet vendore, si ofrues të këtyre shërbimeve. Objektivat e tyre kryesore janë të lehtësojnë qeverisjen efektive të flukseve të migracionit, të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve të plota për migrantët dhe të promovojnë zhvillimin rajonal të balancuar. Duke zbatuar këto procedura të standardizuara, Shqipëria mund të adresojë më mirë realitetet e migrimit të brendshëm dhe të mbështesë qëndrueshmërinë dhe mirëqenien e komuniteteve të saj.

¹ Udhëtimi përpara, Mbështetje për Migrimin e Suksesshëm në Evropë dhe Azinë Qendrore, Banka Botërore, 2024, e disponueshme në <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/journey-ahead-supporting-successful-migration-in-europe-and-central-asia>, aksesuar më Nëntor 19, 2024;

² VKM Nr. 173, datë 24.03.2023 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023-2030, Planit të Veprimit për zbatimin e saj, si edhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024;

2. Modelet e Migrimit të Brendshëm në Shqipëri

Migrimi i brendshëm në Shqipëri ka luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e peizazhit demografik dhe socio-ekonomik të vendit. Ky fenomen reflekton si zhvillimet historike ashtu edhe sfidat e një ekonomie në tranzicion.

Gjatë periudhës komuniste, qeveria shqiptare synonte të kontrollonte lëvizjet e popullsisë përmes politikave që kishin për qëllim promovimin e rritjes industriale dhe urbane. Krijimi i qendrave të reja urbane shpërndau fuqinë punëtore për të mbështetur zhvillimin industrial. Pavarësisht përpjekjeve të shtetit për të rregulluar migrimin, lëvizjet nga zonat rurale në zonat urbane vazhduan të kontribuonin në rritjen e popullsisë urbane, veçanërisht në harkun e viteve 1950 dhe 1960. Migrimi i brendshëm nga një zonë rurale në një tjetër ka ndodhur gjithashtu, veçanërisht nga rajonet më të pazhvilluara të veriut dhe jugut në zonat më të pasura fushore perëndimore dhe bregdetare. Këto lëvizje, ndonëse të kufizuara pjesërisht nga regjimi, treguan fillimet e hershme të modeleve të migrimit të brendshëm të nxitura nga pabarazitë ekonomike dhe gjeografike.

Rënia e komunizmit në vitin 1990 shënoi një ndryshim dramatik në dinamikën e migrimit të brendshëm në Shqipëri. Pasiguria ekonomike dhe kalimi në një ekonomi tregu shkaktuan migrim në shkallë të gjerë nga zonat rurale dhe malore në qendrat urbane. Tirana, kryeqyteti, së bashku me qytetet e tjera bregdetare si Durrësi e Vlora, u bënë destinacionet kryesore për këta migrantë të brendshëm. Kjo valë migrimi u nxit nga një kombinim faktorësh shtytës, si varfëria dhe infrastruktura e kufizuar në zonat rurale, dhe faktorëve tërheqës, duke përfshirë premtimin për punësim, arsimim dhe kushte më të mira jetese në qendrat urbane. Urbanizimi i shpejtë rriti diferencat midis rajoneve, pasi zonat rurale u bënë më të zbratura dhe më të dobëta ekonomikisht.³

Aktualisht në Shqipëri, migrimi i brendshëm vazhdon të dominohet nga lëvizjet drejt zonave urbane, veçanërisht Tiranës, e cila ka njohur një rritje eksponenciale si qendër politike, ekonomike dhe kulturore e vendit. Rajonet rurale, veçanërisht në veri dhe zonat malore, kanë përjetuar shpopullim të vazhdueshëm. Mundësitë e kufizuara ekonomike, infrastruktura e pamjaftueshme dhe perspektivat në rënie të bujqësisë në këto rajone, shtojnë të rinjtë e popullsisë të kërkojnë mundësi më të mira në mjediset urbane. Të rinjtë janë nxitësit kryesorë të migrimit të brendshëm. Ata kërkojnë arsim, punësim dhe stile jetese moderne në zonat urbane. Kjo tendencë ka lënë zonat rurale me popullsi të plakur dhe një forcë punëtore të reduktuar.⁴

³ Migrimi në Shqipëri, mund të gjendet në <https://albania.iom.int/migration-and-albania>, aksesuar në 19 Nëntor, 2024;

⁴ INSTAT, Modelet e Urbanizimit në Shqipëri, <https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST>;

2.1 Dinamikat Aktuale të Migrimit të brendshëm

Profili i Zgjeruar i Migracionit (PZM) paraqet një panoramë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar të trendeve dhe të dhënave të migracionit, duke ofruar një pamje të azhurnuar të modeleve të migrimit, trendeve aktuale dhe projeksioneve. PZM thekson pasojat më të gjera të migrimit, veçanërisht ndikimin e tij në ndryshimet demografike dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Duke paraqitur një pamje të integruar të trendeve të migracionit dhe përgjigjeve të politikave, ky raport shërben si një mjet i vlefshëm për të kuptuar natyrën shumëdimensionale të migrimit dhe rolin e tij në formësimin e peizazhit socio-ekonomik të Shqipërisë.

Profili i Zgjeruar i Migracionit për periudhën 2019-2025⁵ thekson se ndryshimet demografike në qarqet e Shqipërisë, përfshirë rritjen ose uljen e tyre, ndikohen ndjeshëm nga migrimi i brendshëm. Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile pranë Ministrisë së Brendshme, migrimi i brendshëm mbetet një faktor kyç në riformësimin e peizazhit demografik të vendit. Gjatë viteve të fundit, një numër i konsiderueshëm banorësh janë zhvendosur brenda vendit, duke ndryshuar qarkun, qytetin ose fshatin ku zakonisht banojnë.

Të dhënat vjetore tregojnë luhatje të dukshme në modelet e migracionit të brendshëm. Rreth 17,000 banorë u zhvendosën në vitin 2019, një shifër që ra në rreth 14,000 në vitin 2020, gjë që me shumë gjasa lidhet me kufizimet e lëvizjes të vendosura gjatë pandemisë COVID-19. Numri u rikuperua në vitin 2021, duke arritur përsëri rreth 17,000, por ra në 15,000 në vitin 2022.

PZM gjithashtu thekson se migrantët e brendshëm janë kryesisht të rinj, me mbi 50% që i përkasin grupmoshës 20–34 vjeç. Dinamikat gjinore tregojnë më tej se gratë shfaqin një prirje më të lartë për të migruar. Në vitin 2022, gratë përbënin 60.5% të të gjithë migrantëve të brendshëm, duke shënuar një rritje prej 1.97% krahasuar me vitin 2021.

Gjatë periudhës 2019–2022, Tirana ishte i vetmi qark në Shqipëri që përjetoi migrim të brendshëm pozitiv, ndërsa të gjitha prefekturat e tjera regjistruan migrim të brendshëm neto negativ. Ky trend ishte veçanërisht i dallueshëm në qarqet Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës. Migrimi i brendshëm ka ndikuar ndjeshëm në sektorë kryesorë të shoqërisë, përfshirë shëndetësinë. Të dhënat e EPM theksojnë se si migrimi i brendshëm ka ndikuar konfigurimin e rrjeteve të ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe rrjedhimisht ka ndikuar në aksesin në shërbimet shëndetësore.

⁵ VKM nr. 50, datë 31.01.2024, “ Për miratimin e profilit të zgjeruar kombëtar të migracionit për vitet 2019-2022”;

Lëvizja mbizotëruese e popullsisë nga zonat rurale drejt qendrave urbane, veçanërisht drejt kryeqytetit, ka prishur ekuilibrin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Në zonat që përjetojnë depopullim, raporti i mjekëve dhe infermierëve me popullsinë e mbetur ka ndryshuar, por kjo rënie nuk përputhet në mënyrë proporcionale me rritjen e kërkesës për shërbime shëndetësore në zonat urbane pritëse. Për më tepër, të dhënat mbi mbulimin shëndetësor gjatë këtyre katër viteve tregojnë një rënie në numrin e mjekëve të familjes në kujdesin parësor, me uljet më të theksuara të vërejtura në zonat rurale. Ky trend nxitet pjesërisht nga migrimi i vetë profesionistëve të shëndetësisë, të cilët po zhvendosen gjithnjë e më shumë nga zonat rurale në ato urbane, duke pasqyruar zhvendosjen e përgjithshme të popullsisë por edhe nga emigrimi.

Përqendrimi i migrimit të brendshëm në qendrat urbane ka sjellë sfidat e veta. Rritja e shpejtë urbane në qytete si Tirana ka ushtruar presion mbi infrastrukturën, strehimin dhe shërbimet publike, duke çuar në probleme si mbipopullimi dhe zgjerimi i zonave informale. Ndërkohë, zonat rurale vazhdojnë të përballen me një ngecje socio-ekonomike, me pak investime për të kundërbalancuar humbjen e kapitalit njerëzor.

Përballimi i këtyre sfidave kërkon një qasje shumëdimensionale të politikave. Në të njëjtën kohë, është thelbësore të përqendrohet vëmendja te integrimi i migrantëve të brendshëm në zonat urbane ku ata zhvendosen, duke siguruar që ata të kenë qasje në punësim, arsim dhe shërbime gjithëpërfshirëse mbështetëse.

Procesi i integritit mund të lehtësohet duke miratuar procedura standarde veprimi që adresojnë nevojat e ndryshme të migrantëve. Këto procedura duhet të përfshijnë programe të synuara për zhvillimin e aftësive, për t'u përshtatur me tregjet urbane të punës, iniciativa arsimore për të mbështetur si fëmijët ashtu edhe të rriturit, si dhe qasje në strehim dhe kujdes shëndetësor të përballueshëm. Duke përmirësuar përfshirjen sociale dhe ekonomike, qendrat urbane mund të përballojnë më mirë fluksin e migrantëve të brendshëm dhe të krijojnë mundësi më të barabarta për të gjithë banorët.

Ndërsa migrimi i brendshëm paraqet mundësi për rritje ekonomike dhe modernizim, ai gjithashtu thekson nevojën urgjente për sisteme mbështetëse gjithëpërfshirëse për migrantët. Këto përpjekje janë thelbësore jo vetëm për të zbutur sfidat, por edhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të siguruar që migrimi i brendshëm të kontribuojë pozitivisht në progresin e vendit.

3. Qëllimi

Qëllimi i hartimit të Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) është të krijojë një kornizë të qartë dhe gjithëpërfshirëse për të mbështetur integrimin e migrantëve të brendshëm në mjediset e tyre të reja. Sipas përkufizimit të ofruar nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)⁶, migrimi i brendshëm i referohet lëvizjes së individëve ose grupeve brenda një shteti, duke përfshirë të gjitha llojet e mobilitetit, pavarësisht nga kohëzgjatja, përbërja ose shkaqet e tij themelore. Ky përkufizim i gjerë përfshin forma të ndryshme migrimi, qoftë vullnetar apo të detyruar, dhe përfshin lëvizje afatshkurtra dhe afatgjata.

Vendimi për të migruar shpesh ndikohet nga një gamë faktorësh, përfshirë arsimin, sfidat ekonomike dhe sociale, degradimin mjedisor ose një kombinim të këtyre. Përveç kësaj, individët mund të migrojnë në kërkim të kushteve më të mira të jetesës ose mundësive më të mira, ndërsa të tjerë mund të motivohen nga arsye si ribashkimi familjar. Duke adresuar këto shtysa të ndryshme dhe kompleksitetet e migrimit të brendshëm, Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) synojnë të ofrojnë udhëzime efektive për të siguruar që nevojat e migrantëve të plotësohen dhe të drejtat e tyre të mbrohen, duke nxitur integrimin e suksesshëm dhe kohezionin shoqëror në mjediset e tyre të reja.⁷

Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) do të kontribuojë në një qasje të strukturuar të bashkive në kryerjen e detyrave dhe proceseve që lidhen me migrimin e brendshëm. Këto procedura synojnë të plotësojnë kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, me qëllim që të sigurohet që migrantët të jenë të informuar, të përgatitur siç duhet dhe të mbështetur gjatë gjithë procesit të migrimit, për të përmirësuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Procedurat Standarde të Veprimit janë thelbësore për të siguruar që të gjithë punonjësit ndjekin të njëjtat udhëzime, duke ndihmuar në ruajtjen e një standardi të lartë cilësie në shërbimet e ofruara. Duke ofruar udhëzime të detajuara dhe hap pas hapi, PSV-të garantojnë qëndrueshmëri dhe mbajnë standarde të larta cilësie në zbatimin e të gjitha proceseve dhe ofrimin e shërbimeve në nivel bashkiak.

Për më tepër, PSV-të përmirësojnë efikasitetin duke përcaktuar mënyrat më efektive për punonjësit bashkiakë që të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Kjo pakëson kohën dhe përpjekjet e nevojshme, minimizon gabimet dhe eliminon përsëritjet, duke çuar në rritjen e produktivitetit dhe racionalizimin e operacioneve. Ato gjithashtu shërbejnë si një mjet i vlefshëm trajnimi për punonjësit e rinj, duke u ofruar atyre një kuptim të qartë të përgjegjësiave të tyre dhe procedurave që duhet të ndjekin.

PSV-të janë hartuar në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe me objektivat strategjike kombëtare dhe vendore në fushën

⁶ Përkufizimi i IOM mbi migrimin, gjendet në Ligjin Ndërkombëtar të Migrimit Nr. 34 – Fjalor mbi Migrimin / Platformat e Publikimit të IOM, aksesuar në Nëntor 13, 2024;

⁷ <https://www.iom.int/global-compact-migration>;

e migrimit. Si të tilla, ato shërbejnë si një mjet thelbësor për mbështetjen e punëve të përditshme, sigurimin e pajtueshmërisë me legjislacionin përkatës dhe avancimin efektiv të qëllimeve strategjike.

4.Parimet dhe Standardet

4.1 Parimet

Përveç parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për migrimin e brendshëm synojnë krijimin e një mjedisi ku të gjithë kanë mundësi për të arritur sukses. Këto PSV bazohen në parimet e mëposhtme:

Qasje e Barabartë, Mosdiskriminim dhe Përfshirje: Të gjithë migrantët e brendshëm që kërkojnë informacion dhe mbështetje kanë të garantuar qasje të barabartë në informacion, burime dhe shërbime, pa asnjë formë diskriminimi. Shërbimet e ofruara u përshtaten nevojave të ndryshme të të gjithë migrantëve, përfshirë gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe minoritetet etnike. Çdo individ, pavarësisht prejardhjes, gjinisë, etnisë, aftësisë së kufizuar ose statusit socio-ekonomik, trajtohet me drejtësi dhe respekt, duke siguruar që informacioni për mundësitë dhe të drejtat të jetë lehtësisht i kuptueshëm.

Mbështetja e Individualizuar: Mbështetja për migrantët udhëhiqet nga një qasje e individualizuar dhe gjithëpërfshirëse, që merr parasysh rrethanat unike të secilit individ dhe të familjes së tij. Kjo qasje ka parësore mbështetjen e personalizuar dhe empatike, duke siguruar që migrantët të marrin informacionin e nevojshëm dhe referimet e duhura për procesin e migrimit, duke i fuqizuar ata të marrin vendime të informuara dhe të përballojnë procesin e migrimit me siguri dhe lehtësi.

Subsidiariteti: Shërbimet për migrantët e brendshëm ofrohen në nivelin më të afërt dhe vendor për të adresuar në mënyrë efektive nevojat e tyre, duke synuar përmirësimin e aksesit dhe përgjegjshmërisë. Njëkohësisht, bashkitë vendore fuqizohen për të menaxhuar aspekte të ndryshme të procesit të migrimit, duke adresuar sfidat specifike me të cilat përballen migrantët.

Qasje Gjithëpërfshirëse Institucionale: Mbështetja efektive për migrantët e brendshëm kërkon bashkëpunim dhe koordinim të vazhdueshëm midis të gjitha entiteteve përkatëse për të ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse përmes shërbimeve të integruara, komunikimit efektiv ndërinstitucional dhe koherencës së politikave. Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve dhe angazhimi aktiv i palëve të interesuara janë thelbësore për të siguruar përpjekje dhe burime të harmonizuara, duke fuqizuar institucionet të krijojnë një kuadër mbështetës që i ndihmon migrantët të marrin vendime të informuara dhe të kalojnë me sukses procesin e migrimit.

4.2 Standardet që Udhëheqin Punën e Punonjësve të Bashkive

Siç thekson IOM, migrimi, qoftë i nxitur nga zgjedhja apo nevoja, është një akt guximi. Ky udhëtim shpesh përfshin rreziqe dhe sfida të konsiderueshme, duke e bërë të domosdoshme që ata që janë të përfshirë në lehtësimin e proceseve të migrimit të respektojnë standardet më të larta profesionale dhe etike. Punonjësit bashkiakë, të cilët janë në vijën e parë të ndërveprimit me migrantët, luajnë një rol thelbësor në këtë proces. Është e rëndësishme që ata të ndjekin udhëzime profesionale dhe etike për të garantuar sigurinë, dinjitetin dhe mirëqenien e migrantëve. Në veçanti, këta punonjës duhet të angazhohen për të ndjekur parimet e mëposhtme:

Qasje Profesionale dhe Miqësore: Punonjësit duhet të ruajnë një qëndrim profesional, por dhe të afërt, duke treguar vëmendje dhe ndjeshmëri ndaj rrethanave të secilit individ.

Informacion dhe Shërbime të Personalizuara: Informacioni dhe shërbimet duhet të përshtaten me situatën dhe nevojat e individit, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.

Ndërtimi i Besimit dhe Respektit: Punonjësit duhet të krijojnë një marrëdhënie besimi me individët, duke i trajtuar ata me respekt në çdo moment.

Komunikim Efektiv: Punonjësit duhet të angazhohen aktivisht në komunikim, duke synuar të kuptojnë qartë situatën e individit dhe të ofrojnë shërbime, informacione dhe referime të përshtatshme.

Mësim dhe Përmirësim i Vazhdueshëm: Punonjësit duhet të përditësojnë njohuritë dhe praktikën e tyre bazuar në mësimet e nxjerra nga përvojat e mëparshme, duke ndarë këtë njohuri me kolegët e tyre brenda bashkisë dhe përtej saj për përmirësim të vazhdueshëm.

Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e të Dhënave: Të gjitha informacionet duhet të trajtohen me konfidencialitet, dhe pëlqimi i individit duhet të merret në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.

Dokumentim i Saktë: Punonjësit duhet të plotësojnë formularët me saktësi gjatë intervistimit të migrantëve, duke siguruar që të gjitha informacionet të regjistrohen siç duhet.

5. Fushëveprimi dhe Grupi i Synuar

Këto procedura zbatohen në nivel bashkiak për të thjeshtuar detyrat dhe përgjegjësitë që lidhen me mbështetjen e migrantëve të brendshëm në planifikimin dhe përshtatjen me mjediset e tyre të reja. Bashkitë luajnë një rol kyç në koordinimin me aktorë të ndryshëm, përfshirë institucionet publike, subjektet e sektorit privat dhe organizatat jofitimprurëse. Ky bashkëpunim siguron që migrantët të marrin mbështetje gjithëpërfshirëse duke shfrytëzuar burimet dhe mundësitë e ndryshme të disponueshme.

Përfituesit kryesorë të shërbimeve dhe sistemit të referimit të krijuar nga këto PSV janë migrantët e brendshëm. Procedurat ofrojnë një kornizë të strukturuar për të lehtësuar kalimin e tyre në një komunitet të ri duke ofruar udhëzime mbi aksesin në ndihmë profesionale, kuptimin e kërkesave ligjore dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm. Kjo qasje siguron që migrantët të jenë të informuar dhe të mbështetur gjatë gjithë procesit të zhvendosjes së tyre.

Për më tepër, këto PSV synojnë të krijojnë një mjedis gjithëpërfshirës ku migrantët mund të kenë akses në një gamë të gjerë shërbimesh. Bashkitë, përmes nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet aktorëve, mund të vendosin një sistem mbështetës gjithëpërfshirës për të adresuar sfidat komplekse me të cilat shpesh përballen migrantët. Kjo përfshin ofrimin e udhëzimeve të qarta, referimet në departamentet ose institucionet përkatëse dhe sigurimin e aksesit të vazhdueshëm në shërbimet thelbësore. Gjithashtu, PSV-të theksojnë rëndësinë e regjistrimit dhe mbajtjes së statistikave të migrimit, një element kyç në monitorimin e trendeve dhe zhvillimin e strategjive efektive mbështetëse.

Duke zbatuar këto masa gjithëpërfshirëse, bashkitë mund të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë dhe qëndrueshmërinë e mbështetjes së ofruar për migrantët e brendshëm. Kjo qasje proaktive jo vetëm që adreson nevojat e menjëhershme, por gjithashtu promovon integrimin e qëndrueshëm të komunitetit, rritjen ekonomike dhe zhvillimin afatgjatë.

6. Kuadri përkatës ligjor, i politikave dhe institucional

Çështjet e migrimit janë trajtuar në dokumente të ndryshme politike dhe ligjore, të cilat analizohen në këtë seksion për të ofruar një përmbledhje të shkurtër të objektivave strategjike të Shqipërisë në fushën e migrimit, në veçanti të migrimit të brendshëm, dhe rolin e njësive të vetëqeverisjes vendore në kontributin për arritjen e këtyre objektivave, duke identifikuar gjithashtu çdo boshllëk të mundshëm.

6.1 Kuadri i Politikave Ndërkombëtare

Në vitin 2018, Shqipëria miratoi Paktin Global për Migracionin (PGM)⁸ gjatë Konferencës Ndërqeveritare në Marakesh. Që atëherë, parimet dhe objektivat e PGM janë integruar në politikat dhe kuadrin e menaxhimit të migracionit të vendit. Ky integrim ka forcuar qasjen e Shqipërisë ndaj qeverisjes së migracionit, duke theksuar migrimin e sigurt, të rregullt dhe të organizuar.

Në përpjekjet për të përafruar strategjitë kombëtare me PGM, Qeveria e Shqipërisë ka përfitur nga mbështetja dhe asistenca e IOM-it për të harmonizuar Strategjinë

⁸ Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 19 dhjetor 2018, "Pakti Global për Migracion të Sigurt, të Rregullt dhe të Organizuar" (A/RES/73/195), është e disponueshme në:

<https://www.iom.int/resources/global-compact-safe-orderly-and-regular-migration/res/73/195>;

Kombëtare të Migracionit dhe Planin e Veprimit me PGM, përmes asistencës teknike, konsultimeve dhe nismave për ndërtimin e kapaciteteve. Gjatë këtij procesi janë identifikuar prioritetet në nivele kombëtare, rajonale dhe globale. Si rezultat, është miratuar një strategji gjithëpërfshirëse që synon forcimin e mbrojtjes së të drejtave të migrantëve, përmirësimin e menaxhimit të të dhënave të migracionit dhe nxitjen e bashkëpunimit për të adresuar në mënyrë efektive sfidat e migrimit.

Pakti Global për Migracionin (PGM) pranon lidhjen midis migrimit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar, duke njohur se migrimi i brendshëm shpesh shërben si një pararendës i lëvizjeve ndërkufitare. Ndërsa PGM përqendrohet kryesisht tek emigrimi ndërkombëtar, parimet dhe objektivat e tij ofrojnë udhëzime të vlefshme edhe për menaxhimin e migrimit të brendshëm. Në veçanti, PGM thekson rëndësinë e adresimit të shkaqeve të migrimit, duke përfshirë pabarazitë ekonomike, ndryshimet klimatike dhe aksesin në shërbimet bazë, të cilat janë po aq të rëndësishme për dinamikën e migrimit të brendshëm. Për shembull, Objektivi 2 i PGM synon minimizimin e shkaqeve negative dhe faktorëve strukturorë që i detyrojnë njerëzit të largohen nga vendi i tyre i origjinës, një parim që mund të zbatohet në migrimin e brendshëm për të adresuar pabarazitë rurale-urbane, infrastrukturën e pamjaftueshme dhe mungesën e mundësive ekonomike në zonat rurale.

Për më tepër, PGM promovon zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse që mbështesin të drejtat dhe mirëqenien e migrantëve, pavarësisht statusit apo vendndodhjes së tyre. Kjo përputhet me menaxhimin e migrimit të brendshëm, siç theksohet në Objektivin 15, i cili mbron konceptin e sigurimit të aksesit në shërbimet bazë për migrantët. Autoritetet bashkiake dhe strukturat e qeverisjes vendore mund të përdorin këto dispozita për të zhvilluar strategji që lehtësojnë integrimin e migrantëve të brendshëm në komunitetet e tyre të reja, duke siguruar që ata të kenë akses në strehim, arsim, kujdes shëndetësor dhe mundësi punësimi.

Gjithashtu, PGM inkurajon bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm, mbledhjen e të dhënave dhe hartimin e politikave të bazuara në prova, të cilat janë elemente kyçe për zgjidhjen efektive të sfidave të migrimit të brendshëm. Duke u mbështetur në parimet e PGM, qeveritë vendore mund të krijojnë një kornizë që siguron që migrimi i brendshëm të kontribuojë pozitivisht në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve të tyre.

6.2 Kuadri Kombëtar Ligjor, Institucional dhe i Politikave,

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHEI) 2022-2030⁹ parashikon një të ardhme ku Shqipëria adreson në mënyrë efektive sfidat dhe mundësitë e migracionit, në përputhje me proceset globale të migracionit dhe objektivat e saj për integrimin në BE. Deri në vitin 2030, strategjia synon një qeverisje të plotë të migracionit, duke u fokusuar

⁹ VKM Nr. 88, datë 22.02.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030”;

në menaxhimin e çështjeve dhe sfidave të lidhura me lëvizjet migratore. Qëllimi kryesor është përmirësimi i ndikimit pozitiv të migracionit në zhvillim, duke përfituar si migrantët ashtu edhe shoqëria shqiptare në tërësi.

SKZHEI 2030 fokusohet gjithashtu në përmirësimin e shërbimeve të administratës publike në Shqipëri, me fokus në gjithëpërfshirje dhe aksesueshmëri për grupet vulnerabël, përfshirë migrantët. Prioritetet kryesore në këtë përpjekje janë përmirësimi i qeverisjes vendore dhe decentralizimit, përmirësimi i ofrimit të shërbimeve përmes digjitalizimit dhe përafrimi i shërbimeve publike me standardet evropiane. Strategjia thekson nevojën për të rritur cilësinë e shërbimeve vendore, veçanërisht në sektorë si shëndetësia, arsimi dhe kujdesi social, të cilët janë kritikë për grupet vulnerabël si migrantët, gratë dhe pakicat minoritare. Duke decentralizuar më tej shërbimet dhe duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet bashkive, qeveria synon të sigurojë që administratat vendore të jenë në gjendje të përgjigjen efektivisht ndaj nevojave të këtyre grupeve, veçanërisht në zonat me flukse të mëdha migrimi, si kryeqyteti i vendit.

Angazhimi i qeverisë për përfshirjen sociale është i dukshëm në politikat që synojnë reduktimin e pabarazive dhe diskriminimit ndaj komuniteteve të marginalizuara, përfshirë romët, egjiptianët dhe personat me aftësi të kufizuara. Vëmendje e veçantë i kushtohet nevojave për strehim dhe punësim të grupeve të marginalizuara, përfshirë të rinjtë dhe çiftet e reja, të cilët përballen me vështirësi për të siguruar strehim të përballueshëm për shkak të çmimeve të larta, veçanërisht në Tiranë dhe në zonat e tjera urbane.

Dokumentet strategjike për personat me aftësi të kufizuara dhe minoritetet rome dhe egjiptiane përfshijnë masa për përmirësimin e aksesit në strehim, arsim dhe shërbime shëndetësore. Kjo siguron që migrantët dhe grupet e tjera të cënueshme të integrohen më mirë në shoqëri dhe të përfitojnë nga shërbimet publike, duke përmirësuar cilësinë e jetës dhe mundësitë e tyre për të marrë pjesë në aktivitete sociale dhe ekonomike.

SKZHEI thekson rëndësinë e analizës së trendeve dhe treguesve të migracionit për të arritur objektivat e politikës së migracionit. Për periudhën e ardhshme deri në vitin 2030, sfidat që lidhen me statistikën përfshijnë forcimin e rolit të Sistemit Kombëtar të Statistikave për t'u siguruar institucioneve publike statistika zyrtare të mjaftueshme, të sakta dhe transparente, përmes mobilizimit të burimeve për financimin e programeve dhe projekteve statistikore, si dhe rritjes së kapacitetit të personelit në ministri/institucione/NjVV që janë të përfshira në mbledhjen e të dhënave/statistikave.

*Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030*¹⁰ dhe Plan i saj i Veprimit paraqesin prioritetet e qeverisë shqiptare për menaxhimin efektiv të migracionit përmes një qasjeje ndërsektoriale që maksimizon përfitimet si për migrantët ashtu edhe për shoqërinë shqiptare. Ky dokument strategjik pasqyron angazhimin e qeverisë për të adresuar sfidat e migrimit, duke identifikuar mundësi për të ofruar mbrojtje dhe zgjidhje të qëndrueshme për migrantët dhe për të shfrytëzuar ndikimin e migrimit në zhvillimin e vendit. Për më tepër, strategjia është në përputhje me prioritetet e tjera kombëtare, përfshirë SKZHEI dhe zbatimin e Agjendës 2030, duke siguruar një kuadër të qëndrueshëm dhe të integruar për adresimin e çështjeve të lidhura me migracionin.

Strategjia Kombëtare për Migracionin përqendrohet në forcimin e kapaciteteve institucionale për të siguruar një qeverisje efektive të migrimit. Një element kyç i strategjisë është rishikimi dhe përditësimi i kuadrit ligjor mbi migracionin, i cili synon të sqarojë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve si në nivel qendror, ashtu edhe në atë vendor. Ky proces siguron një përgjigje të koordinuar dhe efikase ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit, duke harmonizuar përpjekjet institucionale për të adresuar në mënyrë efektive si nevojat e migrantëve, ashtu edhe objektivat e zhvillimit të vendit. Strategjia thekson gjithashtu nevojën për zgjerimin e burimeve njerëzore, veçanërisht brenda *Sekretariatit Teknik të Migracionit*, për të forcuar kapacitetet e Ministrisë së Brendshme në drejtimin të menaxhimit efektiv të çështjeve të migracionit.

Sekretariati Teknik për Migracionin, i cili operon në kuadër të Sektorit të Migracionit të Drejtorisë kundër Trafikimit dhe Migracionit, brenda Ministrisë së Brendshme, është përgjegjës për monitorimin e progresit të strategjisë së migracionit dhe planit të saj të veprimit, duke siguruar mbulimin e të gjitha shtyllave të strategjisë.

Strategjia thekson rëndësinë e zhvillimit dhe përditësimit të kurrikulave të trajnimit për të rritur kapacitetet e aktorëve relevantë, përfshirë nëpunësit civilë, njësitë e qeverisjes vendore dhe aktorët e tjerë të përfshirë në menaxhimin e migracionit. Kjo përfshin krijimin e një Njësie të Dedikuar Trajnimi për Migracionin, e cila do të ofrojë zhvillim të vazhdueshëm profesional për ata që janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit mbi migracionin. Trajnimi me ndjeshmëri gjinore është gjithashtu një fokus kryesor, duke siguruar që politikat dhe shërbimet e migracionit të jenë të përgjegjshme nga pikëpamja gjinore, duke marrë në konsideratë nevojat unike të grave dhe grupeve të marginalizuara.

¹⁰ VKM Nr. 271, dt. 02.05.2024 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024–2026”;

Për më tepër, strategjia thekson rëndësinë e krijimit të politikave të bazuar në prova, duke kërkuar zhvillimin e rregullt të profileve të migracionit që ofrojnë të dhëna të rëndësishme mbi trendet e migrimit. Këto profile do të udhëheqin politikat kombëtare dhe vendore të ardhshme, duke siguruar që qeverisja e migrimit të mbetet në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe institucioni i saj vartës, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA), luajnë një rol qendror në zbatimin e nismave që lidhen me migracionin, të cilat synojnë përmirësimin e aksesit në tregun e punës dhe sigurimin e shërbimeve të ndjeshme ndaj gjinisë për migrantët. Ministria, në bashkëpunim me AKPA-në, është përgjegjëse për hartimin dhe shpërndarjen e udhëzuesve që ofrojnë shërbime të ndjeshme ndaj gjinisë në fusha kritike si punësimi, arsimi, trajnimi profesional, investimet dhe strehimi. Këta udhëzues do të jenë të projektuar për të mbështetur integrimin e migrantëve në ekonominë vendore, me një fokus të veçantë te grupet vulenrabel si gratë, të rinjtë dhe komunitetet e marginalizuara.

Për më tepër, Ministria dhe AKPA luajnë një rol kyç në zbatimin e programeve të punësimit, nismave të vetëpunësimit dhe trajnimeve në vendin e punës, veçanërisht në zonat e prekura rëndë nga emigracioni, duke lehtësuar kështu integrimin e migrantëve të brendshëm dhe duke fuqizuar tregun e punës në këto rajone.

Ministria dhe AKPA gjithashtu janë përgjegjëse për lehtësimin e konsultimeve me organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve për të vlerësuar nevojat e tregut të punës, duke përfshirë kërkesat për fuqi punëtore vjetore dhe sezonale në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Këto konsultime janë thelbësore për harmonizimin e politikave të migracionit të vendit me kërkesat dinamike të tregut të punës.

Sa i përket aksesit në informacionin për punësim, Ministria, së bashku me AKPA-në, po shfrytëzon teknologjinë për të maksimizuar arritjen e migrantëve potencialë dhe aktualë. Duke përdorur platforma digjitale, Ministria do të sigurojë që informacioni mbi mundësitë e punësimit, kushtet e punës dhe agjencitë përgjegjëse të arrijë një audiencë të gjerë, me një fokus të veçantë te grupet vulnerabel si të rinjtë dhe gratë. Për më tepër, AKPA do të kontribuojë në publikimin e një liste të agjencive private të punësimit të licencuara dhe agjencive të punësimit të përkohshëm në portalin e saj, duke u ofruar migrantëve të brendshëm burimet e nevojshme për t'u orientuar tregun e punës dhe për të siguruar mundësi të përshtatshme punësimi.

Nëpërmjet këtyre përpjekjeve të kombinuara, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, së bashku me AKPA-në, do të luajnë një rol kyç në përmirësimin e

perspektivave të punësimit për migrantët, duke kontribuar njëkohësisht në strategjinë e përgjithshme të menaxhimit të migracionit të vendit.

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) kanë një rol qendror në zbatimin e strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit mbi migracionin duke shërbyer si urë lidhëse midis politikave të qeverisë qendrore dhe komuniteteve që ato qeverisin. Një nga përgjegjësitë e tyre kryesore është krijimi dhe forcimi i strukturave vendore të dedikuara për migracionin dhe diasporën. Gjithashtu, ato janë të ngarkuara me përgjegjësinë e zhvillimit të planeve vendore të ndjeshme ndaj gjinore, që adresojnë nevojat dhe sfidat specifike të popullsisë migrante, duke siguruar gjithëpërfshirje dhe barazi.

NJVV-të gjithashtu kanë një rol kritik në angazhimin komunitar dhe ndërtimin e kapaciteteve. Ato mbajnë përgjegjësinë kryesore për informimin e migrantëve mbi shërbimet publike dhe jo publike të disponueshme, që lehtësojnë proceset e tyre të integritetit. Për më tepër, NJVV-të duhet të sigurojnë që të drejtat e migrantëve të mbrohen brenda komunitetit dhe t'i përfshijnë ata aktivisht në proceset e vendimmarrjes vendore, duke promovuar kohezionin shoqëror dhe përfitimin e ndërsjellë.

Për të mbështetur këto përpjekje, NJVV-të mund të mbajnë informacion të përditësuar mbi shërbimet dhe nismat e disponueshme për migrantët, në bashkëpunim me institucionet dhe partnerët zhvillimorë. Duke përditësuar rregullisht materialet si *online* ashtu edhe *offline*, ato sigurojnë udhëzime të qarta dhe mbështetje efektive për integrimin e migrantëve. Në bashkëpunim me institucione të tjera publike, NJVV-të janë gjithashtu përgjegjëse për hartëzimin e organizatave joqeveritare që ofrojnë shërbime të lidhura me migracionin dhe për t'i bërë këto informacione lehtësisht të aksesueshme. Duke përmbushur në mënyrë të kujdesshme këto përgjegjësi, NJVV-të kontribuojnë në zbatimin e suksesshëm të strategjisë së migracionit, duke nxitur komunitete gjithëpërfshirëse dhe duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm në nivel vendor.

Përveç forcimit të kuadrit institucional dhe ndërtimit të kapaciteteve, strategjia nënvizon nevojën për mbrojtjen e të dhënave personale të migrantëve përmes trajtimit të përgjegjshëm të të dhënave. Ajo synon krijimin e një praktike të unifikuar për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave mbi migrimin, duke siguruar që ato të jenë të ndara sipas gjinisë, moshës dhe karakteristikave të tjera përkatëse. Këto të dhëna do të shërbejnë si një bazë e fortë për zhvillimin e politikave të migracionit të bazuara në prova dhe që mund të përgjigjen më mirë ndaj dinamikave të ndryshueshme të migracionit. Përmes këtyre veprimeve të planifikuara në dokumentin aktual të politikës kombëtare të migracionit, nën drejtimin e *Ministrit të Brendshme*, Shqipëria do të pozicionohet për të adresuar në mënyrë efektive sfidat e migracionit. Vlerësimi i indikatorëve të qeverisjes së

migracionit tregon se Shqipëria ka politika dhe procedura për identifikimin e duhur dhe në kohë të migrantëve në nevojë dhe për t'u ofruar atyre shërbime të përshtatshme referimi dhe mbrojtjeje.¹¹

Duke plotësuar parashikimet e Strategjisë Kombëtare për Migracionin, *Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë*¹² thekson punësimin cilësor dhe zhvillimin e aftësive gjatë gjithë jetës për të gjithë, me një fokus të veçantë në përmirësimin e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune. Ky vizion është thelbësor për adresimin e sfidave të migrimit të brendshëm, pasi siguron që migrantët e brendshëm të kenë qasje në mundësi për zhvillim aftësish dhe punësim produktiv, duke mundësuar integrimin e tyre efektiv në tregjet vendore të punës. Duke përmirësuar funksionimin e tregut të punës dhe duke promovuar qasjen gjithëpërfshirëse në punësim, strategjia do të mbështesë kohezionin social dhe rritjen ekonomike në të gjitha rajonet, duke reduktuar pabarazitë dhe duke nxitur zhvillimin e balancuar. *Plani i Zbatimit të Garancisë për Rininë* ofron një siguri shtesë për angazhimin dhe fuqizimin e të rinjve.

Objektivi strategjik që vendos në prioritet një treg pune më funksional për të gjithë, nënvizon rëndësinë e masave të synuara për të mbështetur migrantët e brendshëm në kapërcimin e pengesave për punësim dhe zhvillimin e aftësive. Këto masa përfshijnë programe trajnimi të përshtatura, akses të përmirësuar në shërbimet e gjetjes së punës dhe nxitjen e lidhjeve midis migrantëve të brendshëm dhe industrive vendore. Duke u përafruar me qëllimet më të gjera të Agjendës 2030, veçanërisht ato që lidhen me reduktimin e pabarazive (Qëllimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 10) dhe sigurimin e punës së denjë për të gjithë (QZHQ 8), strategjia shërben si një gur themeli për krijimin e kanaleve gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për migrantët e brendshëm, duke i ndihmuar ata të përparojnë në mjediset e tyre të reja.

Nga ana tjetër, objektivat e *Strategjisë për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore*¹³ janë të përqendruara në promovimin dhe forcimin e zhvillimit të qëndrueshëm vendor. Qëllimet kryesore përfshijnë përmirësimin e cilësisë, standardeve dhe ofrimit të shërbimeve vendore. Kjo përfshin rritjen e kapaciteteve dhe efikasitetit të qeverive vendore për të përmbushur nevojat e banorëve të tyre me shërbime me cilësi të lartë.

¹¹ Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), 2023. Treguesit e Qeverisjes së Migracionit: Profili i Dytë 2023 – Republika e Shqipërisë. IOM, Gjenevë, i disponueshëm në: <https://publications.iom.int/books/treguesit-e-qeverisjes-se-migracionit-profili-i-dyte-2023-republika-e-shqiperise>, aksesuar në 19 Nëntor, 2014;

¹² VKM Nr. 173, datë 24.03.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2023-2030, Planit të Veprimit për zbatimin e saj dhe Planit të Zbatimit të Garancisë për Rininë";

¹³ VKM Nr. 252, datë 20.04.2023, titulluar "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, të Planit të saj të Veprimit 2023-2025 e të Pasaportës së Indikatorëve";

Gjithashtu, strategjia thekson zgjerimin e qeverisjes digjitale në nivel vendor. Duke integruar më shumë mjete dhe platforma digjitale, qeveritë vendore mund të ofrojnë shërbime dhe programe në mënyrë më efikase dhe transparente. Ky transformim digjital synon të reduktojë kostot, të rrisë aksesin dhe të përmirësojë përgjegjshmërinë e përgjithshme të administratave vendore. Së bashku, këto objektiva synojnë të krijojnë një kuadër qeverisjeje vendore më efektiv, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt së ardhmes, i cili mund të shërbejë më mirë nevojave të të gjithë qytetarëve.

6.3 Kuadri i Politikave Vendore

Shumë bashki kanë miratuar Planet Vendore për Migracionin dhe Diasporën, të cilat përfaqësojnë hapa pozitivë drejt adresimit të çështjeve të migracionit dhe diasporës. Bashkia e Tiranës ka vendosur një shembull duke marrë përsipër përgjegjësitë e reja të njësisë të vetëqeverisjes vendore në lidhje me migracionin, duke miratuar Planin Vendor për Migracionin dhe Diasporën për vitet 2022-2026.¹⁴ Ky plan synon të krijojë kushtet e nevojshme për integrimin e qëndrueshëm të migrantëve duke shfrytëzuar sistemet e informimit dhe duke nxitur bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm. Ai mbështetet në të dhëna statistikore mbi rritjen e popullsisë në Bashkinë e Tiranës dhe njeh kërkesën në rritje për shërbime publike të përmirësuara. Në mënyrë të ngjashme, bashki të tjera, përfshirë Korçën¹⁵, Shkodrën, Kukësin, Dibrën dhe Elbasanin, kanë zhvilluar gjithashtu planet e tyre vendore për migracionin dhe diasporën.

Megjithatë, këto plane vendore u formuluan dhe u miratuan përpara miratimit të strategjive aktuale për zhvillim, integrim evropian dhe migracion. Si rezultat, ato nuk janë plotësisht në përputhje me vizionet dhe objektivat e përcaktuara në këto dokumente strategjike të fundit. Kjo mungesë sinkronizimi paraqet sfida, pasi planet vendore nuk pasqyrojnë plotësisht kuadrin kombëtar të përditësuar dhe gjithëpërfshirës, i cili synon të adresojë çështjet dhe mundësitë aktuale të migracionit.

Për më tepër, këto plane tregojnë një fokus të lavdërueshëm në riintegrimin e migrantëve të kthyer dhe nxitjen e ndërveprimit me diasporën, duke dëshmuar përkushtim për mbështetjen efektive të këtyre grupeve. Theksi mbi riintegrimin reflekton përpjekjet për të adresuar nevojat e migrantëve të kthyer dhe për të forcuar lidhjet me diasporën, të cilat janë aspekte thelbësore të menaxhimit të migracionit. Megjithatë, këto plane janë të pamjaftueshme në ofrimin e dispozitave të përshtatshme për ndihmën e qytetarëve shqiptarë që kanë migruar brenda vendit, çka përfaqëson një mungesë në kuadrin vendor të menaxhimit të migracionit.

¹⁴ Gjendet në: https://tirana.al/uploads/2022/6/20220610110954_plani-vkb-nr20-date-642022.pdf;

¹⁵ Gjendet në: <https://bashkiakorce.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/Planit-Vendor-te-Veprimit-per-Migracionin-dhe-Diasporen-2022-2025.pdf>

Miratimi i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për migracionin e brendshëm do të adresojë në mënyrë efektive këtë boshllëk duke udhëzuar bashkitë në ofrimin e mbështetjes gjithëpërfshirëse për migrantët e brendshëm. Duke miratuar PSV-të dhe duke adresuar këtë mangësi, bashkitë mund të përafrojnë më mirë përpjekjet e tyre me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare të migracionit. Ky hap është thelbësor për të nxitur një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në menaxhimin e migracionit, që përmbush nevojat e ndryshme të migrantëve dhe përmirëson qeverisjen e përgjithshme të migracionit.

Një nga aspektet kryesore të theksuara në këto plane vendore është krijimi dhe forcimi i strukturave ose njësive të dedikuara për çështjet e migracionit dhe diasporës. Ky fokus institucional është kritik për të siguruar menaxhimin sistematik dhe të qëndrueshëm të çështjeve të migracionit në nivel vendor. Megjithatë, këto plane nënvizojnë gjithashtu një boshllëk të rëndësishëm që rezulton nga mungesa e Procedurave Standarde të Veprimit për adresimin e segmenteve të tjera të migracionit. Kjo mungesë nënvizon nevojën për qasje më gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar për të trajtuar në mënyrë efektive të gjitha aspektet e migracionit, duke përmirësuar gjithëpërfshirjen dhe efektivitetin e planeve vendore.

Miratimi i këtyre PSV-ve mund të nxisë bashkitë të përditësojnë planet e tyre vendore të migracionit, duke i përshtatur ato me strategjitë e reja kombëtare. Ky përafrim do të sigurojë mbulim gjithëpërfshirës të të gjitha aspekteve të migracionit, përfshirë mbështetje të fuqishme për migracionin dhe zbatimin e PSV-ve të detajuara. Një koherencë e tillë do të rrisë efektivitetin e menaxhimit të migracionit në nivel vendor, duke nxitur një qasje më të qëndrueshme që plotëson nevojat në ndryshim të migrantëve dhe përshtatet me objektivat strategjike më të gjerë.

6.4 Kuadri Ligjor

